

**VENDIM**  
**Nr.1007, datë 10.12.2010**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E  
BRENDSHME TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË PRONËS NR.6 “PALESTËR E REPARTIT  
RENEA, TIRANË”, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE  
TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË  
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.203,  
DATË 5.4.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E  
PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTEVE REPARTI, KOMANDA, PALESTRA  
DHE POLIGONI TË REPARTIT RENEA, TIRANË, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE  
MINISTRIA E DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë, të pronës së paluajtshme nr.6, e emërtuar në inventarin e pronave të paluajtshme “Palestër e Repartit Renea, Tiranë”, me vendndodhje në Tiranë, me numër pasurie 7/182, ZK 8330, për t’u përdorur si mjedise pune të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, sipas planimetrisë dhe formularit të inventarizimit të pronës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Prona e paluajtshme, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, me të gjitha elementet përbërëse të saj, hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore të Ministrisë së Brendshme, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Në pikën 1, të vendimit nr.203, datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave, fjalët “e 144 m<sup>2</sup>” shfuqizohen.

4. Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, pas marrjes në përdorim të pronës së përcaktuar në këtë vendim, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e kësaj prone, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Bashkia/komuna Tiranë

[illegible]



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT  
(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT  
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME  
TIRANË

REGJISTRUES

FETAH HASANAJ



A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 8330, NR. PASURISË 7/182

INDEKSI I HARTËS TR-6-10

ADRESA E PASURISË: Rrethi - TIRANË, Q/ TIRANË

Rr/ JORDAN KISKA, P/G \_\_\_\_\_, Sh \_\_\_\_\_

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. \_\_\_\_\_

L. \_\_\_\_\_

J. \_\_\_\_\_

P. \_\_\_\_\_

SHETET

D. Data: \_\_\_\_\_ / 2010, Ora \_\_\_\_\_, Punoi: \_\_\_\_\_

